



Mrëfehët se një mysliman i varfër jetonte vetëm nga peshkimi, por, siç ndodhë me besimtarin, Allahu e sprovoi dhe për ditë të tëra nuk mund të peshkonte gjë.

Ishte gjëja e vetme me të cilën ia siguronte familjes furnizimin, andaj edhe brengosej, sidomos kur furnizimi në shtëpi filloi të pakësohej dukshëm. Çdo ditë dilte në bregdet për peshkim, por kot. Një ditë, pas një kohe të gjatë qëndrimi në bregdet, tha në vete: Kjo le të jetë hera e fundit për sot! -dhe hodhi rrjetën. Priti pak ndërsa rrjeta filloi të rëndohej. Kuptoi se kishte zënë diçka. Kur e nxori, pa se kishte zënë një peshk goxha të madh, që kurrë më parë nuk kishte peshkuar të tillë. U gëzua shumë por jo gjatë. Në fakt, peshkatari falënderoi Allahun shumë dhe mendoi, përveç që një pjesë do ta shfrytëzojë për ushqim, tjetrën do ta ndajë për shtiye dhe për lëmoshë. Kështu do të vepronte sikur mbreti që kaloi pranë të mos e shihte peshkun. Ishte vërtet peshk i rrallë. Ushtria kërkuan që ta jap peshkun për mbretin por peshkatari refuzoi. Pranoi vetëm tua shiste, por ata ia morën me dhunë.

Kur u kthyen në pallat, mbreti kërkoi që t'ia gatuanin atë peshk për darkë, shijen e të cilit do ta kuptonte vetëm pas pak ditësh, atëherë kur do të zbulohej se mbreti ishte sëmurë nga gangrena. I thirrën mjekët ndërsa ata pas kontrollimit i propozuan mbretit që t'i nënshtrohet një operacioni për heqjen e gishtërinjve të këmbës për të parandaluar sëmundjen, e cila kërcënon edhe nëngjurin e tij. Mbreti refuzoi këtë dhe parapëlqeu që ta durojë dhimbjen, por, u pa se vendimi i tij ishte i gabuar. Pas vetëm pak ditësh u detyruan t'ia sillnin disa mjekë tjerë, jashtë vendit, për kontrollim, dhe vetëm pas herës së tretë kur u vërtetua se sëmundja kishte arritur deri tek gjuri, mbreti pranoi t'i nënshtrohej operacionit.

Kjo që i ndodhi mbretit e shqetësoi atë pa masë, andaj, mendoi ta thërriste një njeri të urtë e ta pyeste për këtë gjë. Ia sollën një njeri të mençur, të cilin mbreti e pyeti se çfarë mund të ketë qenë shkak i kësaj fatkeqësie të tij. Njeriu i urtë i tha: Patjetër se ti i ke bërë padrejtësi dikujt! Mbreti iu përgjigj me habi: Nuk më kujtohet t'i kem bërë dikujt padrejtësi. Kujtohu mirë! – i tha njeriu i urtë, ngase kjo nuk ka si të mos jetë shkak i ndonjë padrejtësie të bërë. Atëherë mbretit i ra ndërmend peshku i madh dhe peshkatari. Urdhëroi ushtrinë t'ia sjellin peshkatarin. Ushtria

shkuan në bregdet, dhe si zakonisht, e gjetën në vendin e vet. E morën dhe e sollën tek mbreti, i cili e pyeti: Ma thuaj të vërtetën, çfarë bëre kur ta mora me dhunë peshkun e madh? Nuk bëra asgjë – foli paksa i frikësuar peshkatari. Fol se nuk do të ndodhë gjë e keqe! – i tha mbreti. Atëherë, kur peshkatari u sigurua, foli dhe tha: Kur ti ma more peshkun, u ktheva kah Allahu dhe u luta: **O Zoti im! Ai e tregoi fuqinë e tij ndaj meje, andaj tregoje edhe Ti fuqinë Tënde ndaj tij!**

Mos bë padrejtësi, po pate mundësi,

Ngase fundi i saj çon në keqardhje

Sytë tu flenë ndërsa i dëmtuari rri zgjuar

Lutet kundër teje ndërsa syri i Allahut nuk flenë

Përshtati nga arabishtja: [Sedat ISLAMI](#)